



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 120 Akti**

**Nr. 144 Vendimi**

Tiranë, më 30.4.2019

**V E N D I M**

Trupi gjykues nr. 2, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Olsi Komici** Kryesues

**Roland Ilia** Anëtar

**Valbona Sanxhaktari** Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, më datë 26.4.2019, ora 9:30, zhvilloi në Pallatin e Kongreseve, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Elidjana Kasa**, prokurore/drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, e pranishme në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE :** Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës; Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## **RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Elidjana Kasa është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të saj si prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë. Bazuar në nenin 4, pika 4, dhe në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim, “Komisioni”) ka hedhur shortin, më datë 15.3.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2.
2. Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe grupi i punës i Prokurorisë së Përgjithshme. Subjekti u kontaktua nëpërmjet adresës elektronike, të deklaruar, për hetim të mëtejshëm, ku iu dërgua edhe pyetëtori i përgatitur nga Komisioni dhe pyetje të tjera.
3. Me vendimin e trupit gjykues, datë 21.3.2018, është vendosur kryesues z. Olsi Komici, si dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
4. Është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues që do të kryente procesin e rivlerësimit, e cila ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e trupit gjykues.
5. Më datë 12.4.2019, trupi gjykues, vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Elidjana Kasa, bazuar në të tre kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, ta ftojë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.
6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime dhe prova lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit. Provat e paraqitura nga subjekti u pranuan nga trupi gjykues.
7. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Elidjana Kasa në seancë dëgjimore, më datë 26.4.2019, ora 9:30, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë.

## **SEANCA DËGJIMORE**

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 26.4.2019, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh.
9. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë. Ajo paraqiti dokumente dhe shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe për rrjedhojë edhe procesin e rivlerësimit për znj. Elidjana Kasa në seancën e datës 30.4.2019, në të cilën subjekti ishte i pranishëm.

## **PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit *hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e*

*nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.*

12. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga Inspektoriati i Lartë i KLD-së, së bashku me materialin shoqërues;
- ç) Dokumente shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) Deklarimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- dh) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht dhe ato në seancën dëgjimore.
- e) Denoncimet nga publiku.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

13. Subjekti i deklaramentit, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33<sup>1</sup> të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

14. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konkluduar se:

- a) *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *Nuk ka kryer deklarament të rremë;*
- e) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

15. Megjithatë sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.<sup>2</sup>

<sup>1</sup>*Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaramentet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin, “Për deklaramentimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe “Kodin e Procedurave Administrative”.*

<sup>2</sup>Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera

16. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Elidjana Kasa, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

17. Në përfundim të hetimit administrativ, kur Komisioni krijoi bindjen se provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendosi t'i japë të drejtë subjektit të njihet me rezultatet e këtij hetimi, si dhe me të gjithë dokumentacionin e administruar në dosje.

18. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elidjana Kasa, në deklaratën e saj të pasurisë për procesin e rivlerësimit, por edhe pas verifikimit administrativ të kryer nga ILDKPKI-ja, si dhe nga Komisioni, rezulton se ka në pronësi pasuritë si më poshtë vijon:

19. **Apartament banimi** me sipërfaqe 95.3 m<sup>2</sup>, blerë me kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 10.6.1999, i hipotekuar, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Pukë. **Vlera 800.000 lekë**. Zotërimi: 50%, në bashkëpronësi me bashkëshortin.

20. Burimi i deklaruar i krijimit të pasurisë: (1) kursime nga pagat që nga fillimi i punës, (2) 300.000 lekë borxh pa interes marrë shtetasit A.B.

### Hetimi i kryer nga Komisioni

21. Nga provat e administruara në dosjen e hetimit administrativ, rezulton se kjo pasuri është fituar me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 10.6.1999 nga shtetasja L.Gj.L., tek personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. Gj. K. Sipas kontratës së shitjes së kësaj pasurie rezulton se shitësi e ka përfituar këtë apartament në bazë të ligjit për privatizimin e banesave shtetërore.

Gjithashtu, sipas këtij dokumentacioni, rezulton se kjo pasuri është blerë në vitin 1999 në shumën 800.000 lekë dhe në vitin 2012 është rivlerësuar në shumën 2.162.075 lekë.

22. Komisioni përgatiti analizën financiare lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave për shumën prej 500.000 lekësh për blerjen e kësaj pasurie, e cila rezulton si më poshtë.

Analizë e aftësisë paguese të subjektit & bashkëshortit në periudhën 1996-1999	viti 1996	viti 1997	viti 1998	TOTALI
Të ardhura Gj. K.	182 329 lekë	204 703 lekë	218 352 lekë	605 384 lekë
Të ardhura Elidjana Kasa	229 121 lekë	231 284 lekë	306 923 lekë	767 328 lekë
<b>Totali</b>	411 450 lekë	435 987 lekë	525 275 lekë	1 372 712 lekë
Shpenzime për blerjen e apartamentit Pukë				- 500 000 lekë
<b>Vlera e mbetur</b>				872 200 lekë

23. Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie, huanë e marrë në shumën 300.000 lekë nga shtetasi A.B.

24. Sipas deklaratës së datës 29.10.2016<sup>3</sup>, rezulton se huadhënësi i ka dhënë bashkëshortit të subjektit hua shumën 300.000 lekë, (shumë kjo e krijuar nga aktiviteti i tij si farmacist), pa asnjë lloj interesi apo përfitimi me të drejtën e shlyerjes në afate kohore sipas mundësive të huamarrësit, për arsye të nevojës që ky i fundit kishte për blerje banese në Pukë. Gjithashtu, në

*ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”*

<sup>3</sup> Shih deklaratën e datës 29.10.2016 të deklaruesit A.B. në dosjen e ILDKPKI-së.

këtë deklaratë, huadhënësi ka deklaruar se ky borxh është shlyer pjesë-pjesë sipas mundësive që huamarrësi ka pasur, nga mesi i vitit 2001.

25. Në lidhje me aftësinë paguese të huas, gjatë periudhës 1999-2001, ajo rezulton sipas tabelës së mëposhtme:

Analizë e aftësisë paguese të subjektit & bashkëshortit në periudhën 1999 - 2001	Viti 1999	Viti 2000	Viti 2001	TOTALI
Të ardhura Gj. K.	225 900 lekë	235 999 lekë	75 648 lekë	537 547 lekë
Të ardhura Elidjana Kasa	145 815 lekë	393 219 lekë	449 489 lekë	988 523 lekë
Totali	371 715 lekë	629 218 lekë	525 137 lekë	1 526 070 lekë
Borxh i marrë nga A.B. për blerjen e apartamentit.				- 300 000 lekë
Vlera e mbetur				1 226 070 lekë

26. Nga verifikimi u konstatua se shtetasi A.B. ishte i datëlindjes 1972, dhe se në sistemin elektronik të QKB-së rezulton të jetë i regjistruar si person fizik me aktivitet *farmacist*, prej vitit 1995 dhe aktualisht me status *Aktiv - objekt veprimtarie farmacist*.

27. DRT-ja Shkodër, me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 08.2.2019, konfirmon se shtetasi A.P.B., është tatimpagues i regjistruar pranë organeve tatimore në datën 3.3.1995 si person fizik (me përgjegjësi tatimore: tatim mbi fitimin) dhe me aktivitet “farmacist”.

**28. Përputhen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me hetimin e kryer nga Komisioni dhe dokumentacionin e administruar në dosje. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka patur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie.**

29. Gjatë hetimit administrativ nga aktet e depozituara nga ZVRPP-ja Pukë, ka rezultuar se Elidjana Q. Kasa (Morina) ka pasur të regjistruar në ZVRPP-në Pukë pasurinë nr. \*\*\* , vol. \*\*\* , f. \*\*\* , lloji i pasurisë “apartament banimi” me sipërfaqe totale 69.56 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi me Q.I.M., dhe Sh.Q.M., dhe se me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 26.1.2011, kjo pasuri ka kaluar në emër të shtetasit S.N.L.

30. Nga aktet e vëna në dispozicion nga ZVRPP-ja Pukë, rezulton se pasuria është përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore me kontratën datë 16.9.1993. Me kontratën nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 26.1.2011, rezulton se kjo pasuri i është shitur zotit S.N.L., nga subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e saj, në shumën 1.495.540 lekë. Transkriptimi i pasurisë konfirmohet nga kartela përkatëse e saj.

31. Konstatohet se kjo pasuri (pjesa takuese) nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2003 dhe as në vitin 2011, kohë në të cilën kjo pasuri është shitur.

**32. Sqarim i subjektit:** *Kjo pronë është përfituar sipas ligjit mbi privatizimin e banesave shtetërore nr. 7652 të datës 23.12.1992, dhe unë jam bërë përfitues si pjesë e kësaj familjeje, pa asnjë lloj shpenzimi, ku sipas ligjit të kohës, meqenëse isha pjesë e gjendjes civile më 1 dhjetor 1992, jam vendosur edhe unë në pjesë ideale. Personalisht nuk e kam ndjerë veten kurrë si bashkëpronare me pjesën takuese në pasurinë “apartament banimi” me sipërfaqe totale 69.56 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi të prindërve të mi dhe as nuk kam përfituar pjesë nga kjo pasuri pas shitjes.*

**33. Apartament banimi** me sipërfaqe 91.34 m<sup>2</sup>, ndodhur te kompleksi i banimit “\*\*\*\*”, blloku \*\*\* Kashar, Tiranë. Porositur sipas aktmarrëveshjes, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 29.12.2004, marrë në dorëzim më datë 30.3.2006. Vlera e apartamentit: 37.000 euro, paguar vlera prej 35.000 eurosh, ndërsa vlera prej 2.000 eurosh do të paguhet kur apartamenti të hipotekohet. Pjesa takuese: 50%, në bashkëpronësi me bashkëshortin.

34. Burimi i deklaruar i krijimit: pagesë me këste në euro nga këmbimi në tregun e lirë të kursimeve nga pagat tona, si dhe dhuratë në *cash* për bashkëshortin nga motra dhe vëllai i tij emigrant.

35. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe në deklarin periodik vjetor për vitin 2004.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

36. Referuar përgjigjes së ZVRPP-së Tiranë për ILDKPKI-në, nuk rezultojnë pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit në Tiranë.

37. Nga aktet e administruara në dosjen e ILDKPKI-së, rezultojnë:

- a) personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, me aktmarrëveshjen e datës 29.12.2004, ka porositur apartamentin 2+1 në katin \*\*\*, blloku \*\*\*, hyrja \*\*\*, nën ndërtim, në vlerën 37.000 euro, pranë shoqërisë tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k.;
- b) në aktmarrëveshje është specifikuar mënyra e pagimit të kësaj pasurie, dhe konkretisht është parashikuar se, kësti i parë në shumën 13.000 euro do të paguhet në momentin e nënshkrimit të këtij dokumenti. Më tej, kësti i dytë do të paguhet brenda muajit maj 2005 në po të njëjtën shumë, 13.000 euro, kësti i tretë, brenda muajit gusht 2005 në shumën 5.500 euro, kësti i katërt do të paguhet brenda muajit tetor 2005 në shumën 3.500 euro, dhe kësti i fundit në shumën 2.000 euro, do të paguhet në kohën në të cilën jepet hipoteka;
- c) në aktmarrëveshje është pasqyruar se këstet do të paguheshin në numrin e llogarisë bankare të shoqërisë ndërtimore, në Bankën Ndërkombëtare Tregtare.

38. Nga verifikimi i deklaramit të viteve 2004, 2005 dhe 2006 rezultojnë se, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pagimin e këstit të parë (më datë 29.12.2004) në deklaratën e vitit 2004, në shumën 13.000 euro, ndërsa në deklaratën e vitit 2005 subjekti ka deklaruar pagesën e këstit më datë 7.6.2005, në shumën 13.000 euro, pagesën e këstit më datë 12.9.2005, në shumën 5.500 euro, ndërsa këstin prej 3.500 eurosh e ka deklaruar të paguar në deklaratën për vitin 2006, më datë 27.3.2006.

39. Subjekti rivlerësimit ka paraqitur mandatet e pagesave të cilat rezultuan në përputhje me deklaramet, dhe se këto pagesa janë kryer nëpërmjet bankës në llogarinë e ndërtuesit, siç ishte parashikuar në kontratë.

40. Subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie kursimet nga pagat, si dhe dhuratë në shumën 8.000 USD, nga vëllai dhe 12.000 USD nga motra e bashkëshortit, dhënë bashkëshortit të subjektit në *cash*.

41. Dhuratë në vlerën 8.000 USD dhënë nga vëllai i bashkëshortit, shtetasi D.K.

- a) Subjekti ka deklaruar në deklaratën për “Vetting”, dhuratë në *cash* për bashkëshortin për të paguar apartamentin e banimit 91.34 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi, tek kompleksi i banimit “\*\*\*\*”, blloku \*\*\*, ap. \*\*\*, Kashar, Tiranë, nga vëllai D. K., me një deklaratë mirëbesimi të shkruar dhe nënshkruar nga vetë ai, më datë 23.12.2004, në Pukë.
- b) Subjekti ka deklaruar këtë dhurim në DPV-në viti 2004 me përshkrim, dhuratë nga vëllai D.K., emigrant në \*\*\*, Florida, SHBA.

42. Nga aktet e depozituara në dosjen e ILDKPKI-së rezultojnë e administruar deklarata e datës 23.12.2004, për dhënien e shumës 8.000 dollarë nga shtetasi D.K., emigrant në SHBA.

43. U pyet subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë dhurim dhe aftësitë paguese të shtetasis D.K., e cila sqaroi, ndër të tjera, se ai ka qenë emigrant në SHBA që prej vitit 1997. Subjekti paraqiti dokumentacion mbështetës mbi aftësitë paguese të tyre, si dhe dokumentacion provues lidhur me dorëzimin e këtyre parave nga dhuruesi.

44. Në tabelën financiare vijuese, shikojmë lidhur me aftësinë financiare të dhuruesit.

Të ardhura USA D. & D. K.	D. K.	D. K.	Të ardhura TOTALE
Viti 2000	\$ 6 280		
Viti 2001	\$ 23 386		
Viti 2002	\$ 22 010	\$ -	
Viti 2003	\$ 13 321	\$ 4 700	
Viti 2004	\$ 5 201	\$ 15 022	
Totali	\$ 70 198	\$ 19 722	\$ 89 920
Dhurimi ndaj bashkëshortit të subjektit – Gj. K. më 23.12.2004			\$ -8 000
Të ardhura te mbetura pas dhurimit			\$ 81 920
Të ardhura mesatare MUJORE çifti Kasa			\$ 1 365

45. Dhuratë në vlerën 12.000 dollarë, dhënë nga motra dhe bashkëshorti, shtetasja V.P., emigrante në SHBA.

- Subjekti ka deklaruar në deklaratën për “Vetting”, dhuratë në *cash* për bashkëshortin për pagimin e apartamentit të banimit me sipërfaqe 91.34 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi, Kompleksi i banimit “\*\*\*\*”, blloku \*\*\*, ap. \*\*\*, Kashar, Tiranë, nga motra dhe dhëndri i bashkëshortit, V., dhe P.P., sipas kontratës së dhurimit nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, zyra e noterisë Pukë datë 2.6.2005, si shpërblim ndaj prindërve dhe si vlerësim për përkujdesje ndaj tyre, me burim krijimi, nga kursimet e pagës së punës si emigrant në \*\*\*, Florida, SHBA.
- Subjekti ka deklaruar këtë dhurim në DPV-në viti 2005, me përshkrimin, dhuratë në *cash* për bashkëshortin dhe familjen nga motra dhe dhëndri sipas kushteve të kontratës së dhurimit nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, në dt 02.06.2005.

46. U pyet subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë dhurim dhe aftësitë paguese të shtetasve V.P., dhe bashkëshortit, e cila sqaroi se ata kanë qenë emigrantë në SHBA që prej vitit 1997. Lidhur me burimin e të ardhurave të ligjshme të dhuruesve, subjekti paraqiti dokumentacion mbështetës lidhur me mundësitë financiare të tyre. Po ashtu, subjekti paraqiti dokumentacion provues lidhur me dorëzimin e këtyre parave nga dhuruesit.

47. Në tabelën financiare vijuese, shikojmë lidhur me aftësinë financiare të dhuruesit.

Të ardhura USA P. & V. P.	V. P.	P. P.	Të ardhura çifti P.
Viti 1997	\$ 7 884	\$ 8 592	
Viti 1998	\$ 24 943	\$ 18 347	
Viti 1999	\$ 24 989	\$ 14 712	
Viti 2000	\$ 14 046	\$ 19 123	
Viti 2001	\$ 16 787	\$ 18 912	
Viti 2002	\$ 18 863	\$ 29 099	
Viti 2003	\$ 16 754	\$ 29 659	
Viti 2004	\$ 19 239	\$ 32 817	
Viti 2005	\$ 20 032	\$ 41 555	
Totali	\$ 163 537	\$ 212 816	\$ 376 353
Dhurimi ndaj bashkëshortit të subjektit			\$ -12 000
Të ardhura të mbetura pas dhurimit			\$ 364 353
Të ardhura mesatare MUJORE çifti Kasa			\$ 3 374

48. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë të gjithë dokumentacionin provues lidhur me të ardhurat e ligjshme të dy dhuruesve, në formën e kërkuar ligjore. Subjekti e paraqiti atë fillimisht në origjinal, më tej në seancë, edhe të shoqëruar me vulë apostile.

49. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se përputhen deklaratimet e subjektit me dokumentacion e mbledhur nga hetimi. Po ashtu, trupi gjykues vlerësoi se kjo pasuri ishte blerë me burime të ligjshme.

50. Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se shtetasi Gj. K., ka në pronësi automjetin me targë \*\*\*, regjistruar në Drejtorinë Rajonale Shkodër, \*\*\*, regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tiranë, ndërsa ka pasur në pronësi automjetin \*\*\*, regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tiranë.

51. Nga aktet e depozituara nga DPSHTRR-ja rezultuan se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka blerë me kontratë nr. \*\*\*, datë 9.2.2015 (hartuar në Kosovë) automjetin **autoveturë tip Freelander 1**, shtetasit H.K., në shumën 1.750 euro, paguar në ditën e kontraktimit. Pjesa takuese: 50%, në bashkëpronësi me bashkëshorten.

52. Burimi i krijimit: Kursimet nga pagat të këmbjeryera në tregun e këmbimit valutor.

53. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij aseti (referoju tabelës përmbledhëse financiare).

54. Nga aktet e depozituara nga DPSHTRR rezultoi se automjeti me targë \*\*\*, **autoveturë tip Opel Corsa**, prodhim i vitit 2005, është blerë nga bashkëshorti i subjektit, me Kontratën nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 10.01.2017, nga shtetasit E., dhe D.D., në shumën 240 000 lekë, e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Pjesa takuese 50%, në bashkëpronësi me bashkëshorten.

55. Burimi i krijimit: Kursime nga pagat.

56. Nga analiza financiare duket se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij aseti (referoju tabelës përmbledhëse financiare).

57. Nga verifikimi i kryer në sistemin e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF), nuk rezultuan të dhëna për përdorim apo pronësi të automjeteve të tjera nga ato të deklaruara nga subjekti.

**58. Tokë arë me sipërfaqe 400 m<sup>24</sup>**, në adresën: lagjja “\*\*\*\*”, \*\*\*, Pukë. Pjesa takuese: 50%, në bashkëpronësi me bashkëshortin.

59. Burimi i krijimit: Akti i marrjes së Tokës në Pronësi, nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”. Kjo pasuri është deklaruar në vitin 2016.

60. ZVRPP-ja Pukë ka informuar se, bashkëshorti i subjektit ka në pronësi 400 m<sup>2</sup>, tokë arë në vendlindjen e tij, fshati \*\*\*, e përfutur në bazë të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi, nr. \*\*\*, datë 9.7.1992, por nuk është e regjistruar në sistemin e pasurive të paluajtshme në ZVRPP-në Pukë.

61. Pasuritë financiare:

- a) **Llogari rrjedhëse** për të ardhurat e pagës si prokurore e subjektit, znj. Elidjana Kasa në Raiffeisen Bank, gjendja më datë 31.12.2016, në vlerën - *11,218 lekë*.
- b) **Llogari e pagës** së bashkëshortit mjek, Gj. K., në Raiffeisen Bank, bashkë me kursimet familjare, gjendje më datë 31.12.2016 në vlerën 1.760.070 lekë. Pjesa takuese: 50%, në bashkëpronësi me bashkëshortin.
- c) **Gjendje cash jashtë sistemit bankar** në shumën 400.000 lekë. Në bashkëpronësi me bashkëshortin.
- d) **Depozitë “Mjelmë” në Raiffeisen Bank**, hapur më datë 6.5.2006 dhe e ndryshuar më datë 27.3.2008, hapur për djalin Xh.K., gjendja në vlerën 560.001 lekë.

<sup>4</sup> Referojuni vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2016 i ZVRPP-së Pukë dhe Aktit të Marrjes së Tokës në pronësi nr. \*\*\* akti, datë 9.7.1992, në dosjen e ILDKPKI-së.



e) **Depozitë “Kursime për fëmijë” në Raiffeisen Bank**, hapur më datë 9.4.2010 për vajzën, M.K., gjendja në vlerën 584.503 lekë.

62. Përputhen deklaramet e subjektit me informacionin e administruar në dosje si dhe mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

63. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar të njëjtat pasuri, të deklaruara dhe nga subjekti i rivlerësimit.

64. Analiza ekonomike e kryer nga Komisioni ka rezultuar pozitive në të gjitha vitet e deklaramet.

65. Nga hetimi i kryer Komisioni nuk konstatoi pasuri të fshehura apo pasuri të përdorura, por të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

## **GJETJE TË TJERA**

66. Në DPV-në e vitit 2010, është deklaruar blerja e 20 kompjuterave, me gjithë aksesore dhe tavolina (për sallë internet-kafe) në vlerën 960.000 lekë. Burimi i krijimit: Kredi në Raiffeisen Bank dhe kursime të familjes.

67. Kredi nga Raiffeisen Bank për blerjen e 20 kompjuterave për sallë interneti në vlerën 600.000 lekë. Nr. kontrate \*\*\* datë 1.12.2010, kësti mujor në vlerën 53.872 lekë.

68. Raiffeisen Bank me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.4.2018 ka konfirmuar disbursimin e kësaj kredie në datën 1.12.2010.

69. Në DPV-në e vitit 2011, subjekti deklaroi shtesë në *cash* më datë 28.2.2011 nga shitja e të gjitha pajisjeve të një salle interneti blerë në vitin 2010 në vlerën prej 1.000.000 lekë.

70. Në praktikën e Raiffeisen Bank është administruar kontrata e kredisë bankare datë 26.11.2010, me të cilën rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë nënshkruar marrjen e një kredie në shumën 600.000 lekë me qëllim “Përdorimi i tyre për arsye personale”. Kjo kredi rezulton të jetë disbursuar në datën 1.12.2010, është akorduar për një periudhë 12 mujore dhe nga informacioni bankar rezulton se është mbyllur në datën 25.2.2011.

71. Subjekti është pyetur në lidhje me blerjen dhe shitjen e kompjuterave. Në përgjigjen<sup>5</sup> e dhënë, subjekti ka deklaruar se: *“kompjuterat janë porositur dhe blerë nga bashkëshorti im në dyqanin “\*\*\*” sh.p.k., përballë Ministrisë së Arsimit. Shpenzimet për 20 kompjutera (monitorë, njësi qendrore, tastierë, maus dhe eb camer), plus 1 ruters dhe kabëll LAN, të gjitha në total 600.000 lekë.”*

Për këtë, subjekti ka vënë në dispozicion 2 fletë garanci, përkatësisht të datës 16 dhe 20 dhjetor 2010 të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.

72. Në lidhje me shitjen e kompjuterave, subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën e datës 28.1.2019<sup>6</sup> të vëllait të saj, shtetasit A.M., i cili ka deklaruar se i ka shlyer shumën e kompjuterave bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 900.000 lekë, në ambientet e bankës, duke i bërë me dije se 100.000 lekët e tjera do t’ia shlyente pas marrjes së dokumentacionit të investimit në dorëzim. Z.M., ka sqaruar në këtë deklaratë se, burimi i kësaj shume është tërheqja e vlerës prej 1.500.000 lekë nga llogaria bankare e nënës së tij, znj. Sh.M. Për këtë veprim, subjekti ka vënë në dispozicion transaksionin përkatës bankar<sup>7</sup>.

73. Nga pikëpamja e analizës financiare, në bazë të deklaramet të DVP-së të vitit 2010, si dhe mbështetur në sqarimet që jep subjekti në pyetësonin nr. 4, blerja e këtyre kompjuterave është paraqitur në seksionin e pasurisë me vlerën 960.000 lekë, ndërsa shitja e tyre e deklaruar në

<sup>5</sup> Sipas përgjigjes 3/2 të pyetësonit nr. 4, në dosjen e Komisionit.

<sup>6</sup> Sipas dokumentit bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësonit, nr. 4, në dosjen e Komisionit.

<sup>7</sup> Sipas ekstraktit të llogarisë të Raiffeisen Bank, datë 29.1.2019, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësonit nr. 4, në dosjen e Komisionit.

DVP-në e vitit 2011, është paraqitur si pakësim i pasurisë po në vlerën 960.000 lekë, ndërsa diferenca prej 40.000 lekësh është paraqitur në seksionin e të ardhurave.

74. Gjithashtu, shpenzimet e marrjes së huas prej 600.000 lekësh në Raiffeisen Bank, në datën 26.11.2010, nga ana e subjektit dhe bashkëshortit të saj, janë konsideruar si shpenzim në vitin 2011 (vit kur është shlyer kredia), në vlerën 48.213 lekë.

75. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar lidhur me këtë çështje se ka qenë një përpjekje e tyre për të bërë një biznes me vëllain e saj për të cilën nuk ka qenë tërësisht e bindur. Ata kanë vlerësuar të marrin një kredi për të mos rrezikuar të ardhurat e familjes së tyre. Po ashtu, ka shpjeguar se biznesi ishte i vëllait të saj, bar kafe “\*\*\*”, nga i cili ata u tërhoqën më vonë. (Për më shumë shiko përgjigjet në pyetësonin nr. 4)

#### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë.**

*Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ajo ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka përdorur burime financiare të ligjshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklaram të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.*

Subjekti është treguar bashkëpunues gjatë gjithë periudhës së hetimit kryesisht, duke iu përgjigjur pyetësorit të dërguar, si edhe pyetjeve shtesë në një kohë të shpejtë dhe duke dhënë në mënyrë shteruese informacionin e kërkuar.

#### **B. VLERËSIMI I FIGURËS**

76. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elidjana Kasa (Morina)”. Ky raport është i deklasifikuar<sup>8</sup>.

77. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

78. Nga hetimi administrativ, nuk rezultoi asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

#### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës.**

*Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaramtën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacione nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që ai të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshme për vazhdimin e detyrës.*

#### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

79. Prokuroria e Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e

---

<sup>8</sup> Vendim nr. \*\*\* datë 11.4.2018.

*Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dorëzoi raportin e vlerësimit profesional.*

80. Nga raporti i vlerësimit profesional të paraqitur nga grupi i punës ka rezultuar se nga verifikimi pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, ndaj subjektit, znj. Elidjana Kasa nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

81. Nga vlerësimet e punës së subjektit, znj. Elidjana Kasa për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Elidjana Kasa është vlerësuar **“shumë mirë”** për aftësitë profesionale të treguara prej saj, pasi detyrat e ngarkuara i ka kryer me cilësi.

82. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 25.5.2018 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë për përzgjedhjen e pesë dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, rezulton se znj. Elidjana Kasa shfaq aftësi në kuptimin dhe interpretimin e legjislacionit në fuqi. Ajo përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret. Subjekti ka njohuri rreth parashikimeve të normave të Kodit Penal dhe instituteve të së Drejtës Penale. Po kështu, shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të normave të Kodit të Procedurës Penale.

83. Nga gjetjet në procedimet penale të shortuara, rezulton se subjekti ka administruar në mënyrë efikase ngarkesën e punës që i është caktuar.

#### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional**

*Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, dhe konsiderohet “i aftë”.*

*Trupi gjykues arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit e ka një nivelin të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.*

#### **DENONCIMET E PUBLIKUT**

##### **84. Denoncim<sup>9</sup> i një shtetasi anonim nëpërmjet web-it**

Denoncuesi në përshkrimin e rastit ka informuar se subjekti i rivlerësimit ka fshehur pasuri, pasi disponon dy lokale dhe një kalçeto sporti në qytetin e Pukës. Konkretisht, dy bar kafe “\*\*\*\*” në emër të vëllait A.M., me adresë: rruga “\*\*\*\*” dhe kalçeton sportive po në emër të vëllait, rruga e “\*\*\*\*” në lagjen “\*\*\*\*”, Pukë. Gjithashtu, ky subjekt disponon edhe një apartament në qytetin e Velipojës në të cilin ka disa vite që bën pushime. Këto pasuri nuk justifikohen nga vëllai i subjektit, pasi ai nuk ka punuar prej shumë vitesh. Ky subjekt ka dhe dy apartamente, një në Pukë dhe një në Tiranë, si dhe dy autovetura.

Hetimi i Kryer nga Komisioni:

- a) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2019 drejtuar ZVRPP-së Shkodër për të verifikuar pasuritë e shtetasit A.M., në Shkodër.
- b) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2019 drejtuar ZVRPP-së Shkodër për të verifikuar pasuritë e shtetasit A.M., në Komunën e Velipojës. Ripërsëritur për Komunën e Velipojës.  
→ Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2019, ZVRPP-ja Shkodër nuk konfirmon pasuri në emër të këtij shtetasi.
- c) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2019 drejtuar “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” sh.a. për të verifikuar kontratat e lidhura nga shtetasi A.M.

---

<sup>9</sup> Datë 7 janar 2019

- Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2019, “Ujësjellës Kanalizime Shkodër” sh.a. nuk konfirmon kontrata të lidhura në emër të këtij shtetasi.
- d) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të verifikuar të ardhurat e këtij shtetasi.
- e) Shkresë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2019, me anë të së cilës kërkohet informacion mbi aktivitetin ekonomik të shtetasit A.M.
- DPT-ja me shkresën nr. \*\*\*, datë 24.1.2019, konfirmon se disponon informacion për personin fizik A.Q.M., me NIPT \*\*\* dhe i kërkon DRT-së Shkodër të përcjellë informacion të plotë lidhur me këtë shtetas.
- DRT-ja Shkodër, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2019, në përgjigje të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2019, dërguar nga DPT-ja, informon se shtetasi A.M., është regjistruar pranë DRT-së Shkodër më datë 8.1.2010, me status ligjor Person Fizik (me përgjegjësi tatimore Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin), me aktivitet “Bar Kafe, internet, pemëtari”) dhe ka kaluar në status Pasiv në datën 26.9.2016. Gjithashtu, rezulton se ky subjekt nuk ka dorëzuar asnjëherë deklaratën e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin si dhe nuk ka deklaruar e nuk ka paguar asnjëherë kontributet e sigurimve shoqërore dhe shëndetësore.
- f) Shkresë Ministrisë së Drejtësisë nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2019.
- Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2019, ka dërguar listën e veprimeve noteriale të kryera nga shtetasi A.M., nga ku nuk rezultuan veprime të dyshimta. Ishte një akt noterial kontratë shitjeje/dhurimi/kalim pasurie e paluajtshme, e kryer në vitin 2015, për të cilën u kërkua informacion nga noteri.
- Sipas informacionit të administruar nga noteri, rezulton se ky akt noterial lidhet me shitjen e një pasurie të paluajtshme në qytetin e Pukës, me palë shitëse A., dhe F.M., në vlerën prej 1.530.320 lekësh.
- g) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2019, drejtuar QKB-së për aktivitetin e shtetasit A.M.
- Qendra Kombëtare e Biznesit, me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2019 informon se, nga verifikimet e kryera mbi bazën e emrit, rezulton se:
1. Shtetasi A.Q.M., i datëlindjes 18.2.1966, figuron i regjistruar si person fizik me NIPT \*\*\*, në datën 1.1.1994, me aktivitet “tregtim të artikujve të ndryshëm”, në Pukë. Ky subjekt tregtar rezulton i pezulluar që prej datës 8.1.2010.
  2. Shtetasi A.Q.M., i datëlindjes 18.2.1966, figuron i regjistruar si person fizik me NIPT \*\*\*, në datën 8.1.2010, me aktivitet “Bar-kafe, internet, pemëtari”, në Pukë. Ky subjekt tregtar rezulton aktualisht aktiv.
- gj) Shkresë nga OSHEE-ja nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2018, për të verifikuar kontratat e lidhura nga shtetasi A.M.
- OSHEE, me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2019 informon se me gjeneralitetet (emër, mbiemër) e shtetasit A. M., rezultojnë kontratat e mëposhtme aktive:
1. Kontrata nr. \*\*\*, hapur më 8.6.2015, konsum familjar, në instancën e **Durrësit**, në adresën “Lagjja nr. \*\*\*”.
  2. Kontrata nr. \*\*\*, hapur më 30.11.2008, aktivitet tregtar “bar-kafe”, në instancën e **Durrësit, Fushë Krujë**.
  3. Kontrata nr. \*\*\*, hapur më 31.12.2008, aktivitet tregtar, në instancën e **Gjirokastrës**.
  4. Kontrata nr. \*\*\*, hapur më 3.7.2005, aktivitet tregtar me NIPT \*\*\*, në instancën e **Shkodrës, qyteti Pukë**, adresa: rruga “\*\*\*”.
  5. Kontrata nr. \*\*\*, hapur më 30.9.2009, aktivitet tregtar, në instancën e Shkodrës, **qyteti Shkodër**.
  6. Kontrata nr. \*\*\*, hapur më 4.7.2005, aktivitet tregtar, në instancën e **Shkodrës, qyteti Pukë**, adresa: “\*\*\*”.
  7. Kontrata nr. \*\*\*, hapur më 16.9.1997, aktivitet tregtar, në instancën e Tiranës, **qyteti Tiranë**, adresa: rruga “\*\*\*”.

Nga verifikimi në regjistrin e gjendjes civile rezultuan 9 shtetas me gjeneralitetet (emër, mbiemër) “A.M.” në moshë madhore, me vendbanime si vijon:

- 1 shtetas në qarkun Shkodër, rrethi Pukë;
- 3 shtetas në qarkun Tiranë, rrethi Tiranë;
- 1 shtetas në qarkun Durrës, rrethi Krujë;
- 2 shtetas në qarkun Kukës, rrethi Has,
- 1 shtetas në qarkun Gjirokastrë, rrethi Tepelenë;
- 1 shtetas në qarkun Durrës, rrethi Durrës.

✓ Nga sa më sipër, rezulton personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, A.Q.M., ka lidhur kontrata shërbimi me OSHEE-në vetëm në rrethin e Pukës.

h) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2019 drejtuar ISSH-së, ku kërkohet të dhëna për shtetasin A.M.

→ Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2019, ISSH-ja ka dërguar informacion mbi shtetasin A.M., i datëlindjes 18.2.1966, nga viti 2012 e në vijim. Ky institucion konfirmon se shtetasi A.M., rezulton të ketë qenë i punësuar pranë OSHEE-së, në periudhën qershor 2016 – shkurt 2018, dhe se që nga muaji gusht 2018 përfiton pension invaliditeti.

i) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2019 drejtuar ALUIZNI-t, ku kërkohet të dhëna për shtetasin A. M.

→ Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2019, ALUIZNI<sup>10</sup> Shkodër ka informuar se shtetasi A.Q.M., rezulton si aplikues me dy praktika, përkatësisht nr. \*\*\*, datë 16.12.2014 dhe nr. \*\*\*, datë 9.9.2015 të deklaruar në Bashkinë Pukë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se subjekti ka vetëdeklaruar dy ndërtime pa leje, përkatësisht në vitin 2008 dhe 2009.

j) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2019 drejtuar bankave (24 institucioneve), ku kërkohet të dhëna për shtetasin A.M.

→ Marrë përgjigje negative nga 20 institucione financiare.

→ Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2019, **Procredit Bank** ka konfirmuar disa llogari në lekë me përshkrime të ndryshme.

**Analizë** mbi informacionin e dhënë nga Procredit Bank.

Rezulton se shtetasi A.M., me kontratën e huas dhe hipotekimit nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 26.7.2005 nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 23.11.2006 dhe nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 30.12.2008, ka marrë përkatësisht kredi në shumën 1.250.000 lekë, 2.200.000 lekë dhe 2.300.000 lekë, të cilat rezultojnë të shlyera përkatësisht në datat 23.11.2006, 13.10.2009 dhe 13.10.2009. Në përfitimin e secilës kredi, rezulton se shtetasi M., ka vënë në hipotekë një lokal ushqimor (74 m<sup>2</sup>) të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 17.5.1995 me nr. pasurie \*\*\*, zk \*\*\*, me adresë në Pukë. Në praktikën e marrjes së kredive është administruar vërtetimi i ZVRPP-së Pukë, i lëshuar në datën 23.6.2004, për pasurinë e përshkruar më sipër.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të sjellë nga banka, në përshkrimet e transaksioneve bankare, nuk konstatohen veprime që lidhin subjektin e rivlerësimit, znj. Elidjana Kasa, me personin tjetër të lidhur, konkretisht vëllain e saj, A. M.

→ Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2019, **Raiffeisen Bank** ka konfirmuar se shtetasi A.M., ka llogari “page” në lekë me nr. \*\*\*, me gjendje 6.912 lekë. Njëkohësisht, ky shtetas ka pasur llogari të hapur si “person fizik” me NIPT \*\*\*, i cili aktualisht është i mbyllur.

<sup>10</sup> Ka bashkëngjitur dokumentacionin e vetëdeklarimeve, vërtetime pronësie, harta treguese, etj., gjithsej 26 fletë, në dosjen e Komisionit.

Nga transaksionet bankare në Raiffeisen Bank<sup>11</sup> rezulton se ky shtetas ka përfituar dy kredi përkatësisht:

- në vlerë 3.000.000 lekë, në datën 09.10.2009;
- në vlerë 2.000.000 lekë, në datën 15.10.2009.

→ *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sjellë nga banka, në përshkrimet e transaksioneve bankare, nuk konstatohen veprime që lidhin subjektin e rivlerësimit Elidjana Kasa, me personin tjetër të lidhur, konkretisht vëllain e saj, A.M.*

**k) Është pyetur subjekti i rivlerësimit në pyetëtorin e datës 21.1.2019:**

Cila është lidhja juaj me një aktivitet bar kafe “\*\*\*\*” me adresë: rruga “\*\*\*\*” dhe kalçeton sportive në rrugën e “\*\*\*\*” në lagjen “\*\*\*\*”, në Pukë?

A dispononi ju apartament në Velipojë, në pronësi apo në posedim, apo e keni përdorur atë për pushime verore?

Në përgjigjet e pyetëtorit nr. 4, subjekti ka sqaruar:

- *Ashtu siç u shpjegova me lart, lidhja e bashkëshortit tim dhe përmes tij edhe unë me bar kafe “\*\*\*\*” qëndron në faktin se në dhjetor të vitit 2010, e ditët në vijim, bashkëshorti dhe unë investuam 960.000 lekë (600.000 lekë kredi dhe 360.000 kursimet e familjes) me qëllim përshatjen e këtij lokali si sallë, “Bar kafe \*\*\*\*” dhe shfrytëzimin e saj për biznes, kjo ka qenë lidhje e jona me ‘Bar kafe \*\*\*\*’. Theksoj se kjo lidhje ka zgjatur nga dhjetori 2010, deri më 28.2.2011, kohë në të cilën ky investim iu shit nga bashkëshorti im për vlerën 1.000.000 (një milion) z. A.M., i cili e ka në pronësi këtë objekt. Dua të theksoj se z. A.M. është vëllai im nga nëna dhe babai.*

- *Personalisht unë, bashkëshorti dhe fëmijët e mi nuk kemi asnjë lidhje pronësie me kalçeton sportive në rrugën e “\*\*\*\*” në lagjen “\*\*\*\*”, në Pukë. Ajo çfarë unë di për këtë kalçeto është se, kjo pasuri është krijuar dhe shfrytëzohet nga vëllai im z. A.M.*

- *Nuk kam asnjë banesë në Velipojë, askund në këtë vend apo jashtë Shqipërie, përveç ato të cilat i kam deklaruar në DPV dhe dërguar pranë ILDKPKI-së.*

*Ashtu siç edhe e kam thënë, për mua familjarisht Velipoja ka qenë vendi i pushimeve në verë, sepse kam pasur afërsi me banesën time në Pukë, ka çmimet më të ulta të banesave për netë qëndrimi, por edhe çmimet më të lira të tregut, krahasuar me plazhet tjera në Shqipëri.*

→ Lidhur me këtë denoncim, trupi gjykues nuk gjeti elementë të cilët të ngrinin dyshime lidhur me pasuri të fshehura, apo të paligjshme të subjektit të rivlerësimit.

## **85. Denoncim<sup>12</sup> i shtetasit Gj.P.**

Denoncuesi në denoncimin e tij ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit për dënim të padrejtë të kërkuar ndaj tij.

Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit, rezulton se çështja penale ka përfunduar në të tri shkallët e gjyqësorit. Më konkretisht, vendimi penal nr. \*\*\*, datë 6.12.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, që i përket denoncuesit, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të mbajtjes pa leje “Të armëve luftarake” në të cilin subjekti i rivlerësimit, pasqyrohet në rolin e mbrojtësit të akuzës nga organi i prokurorisë, është lënë në fuqi në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe njëkohësisht nuk është pranuar edhe rekursi i depozituar nga i pandehuri (aktualisht në cilësinë e denoncuesit).

<sup>11</sup> Sipas shkresës nr. \*\*\*prot., datë 21.1.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>12</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2018, në dosjen e Komisionit.

Të gjitha veprimet procedurale të kryera në funksion të këtij procedimi penal janë vlerësuar të ligjshme nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe nga ajo e Apelit.

### **86. Denoncim<sup>13</sup> i shtetasit M.A. (denoncimi IMO)**

Denoncuesi pretendon për marrëdhënie të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës, nisur edhe nga fakti se ajo është edhe vetë nga Puka.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

a) Shkresë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë, nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2019, me anë të së cilës i kërkohet informacion mbi çdo kallëzim/procedim penal ndaj shtetasit Gj. K.

→ Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2019 informon se nuk rezulton asnjë kallëzim penal apo procedim penal i regjistruar në emër të shtetasit Gj. K., si dhe nuk ka asnjë të dhënë apo indice të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me ndonjë dyshim të ngritur në kuptimin penal, dhe atë të cenimit të figurës.

b) Dërguar subjektit të rivlerësimit, përkatësisht në datat 6 dhe 12 mars, një pyetësor, lidhur me konflikte të mundshme të interesit gjatë ushtrimit të detyrës, nisur edhe nga fakti që ajo është lindur dhe rritur në qytetin e Pukës. Kjo pyetje shtrohet edhe nisur nga një kërkesë e subjektit të rivlerësimit drejtuar KLP-së në janar të viti 2019.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 8 mars sqaron se:

*“... në të gjitha rastet ku unë jam gjendur në kushtet e konfliktit të interesit, procedimet penale janë ndjekur nga prokurorët e tjerë të përkohshëm të caktuar pranë kësaj Prokurorie, në rastet kur prokurorëve të çështjes i është ndërprerë caktimi i përkohshëm, atëherë çështja i është caktuar prokurorit tjetër të caktuar përkohësisht, sipas vendimit të zëvendësimit të prokurorit, vendim i cili është marrë nga ana ime si drejtuese e Prokurorisë.*

*Nisur nga rrethanat e lartpërmendura, kur në disa raste unë gjendem në kushtet e pamundësisë së ushtrimit të funksionit të prokurorit, si edhe për shkak të ngarkesës, si pasojë e mungesës së prokurorëve të tjerë sipas Organikës, ishte arsyeja që unë i jam drejtuar me kërkesë Prokurorisë së Përgjithshme dhe KLP-së, për plotësimin e Organikës së kësaj Prokurorie.*

*Unë kam kërkuar zyrtarisht transferimin tim me kërkesë të datës 11.9.2015, për shqyrtimin e mundësisë së transferimit në një prokurori tjetër, duke listuar disa arsye për transferimin tim. Kërkesa ime nuk u miratua, as përgjigje në lidhje me kërkesën nuk më erdhi, qoftë kjo edhe formale, si e tillë s’di të them se cilat ishin arsyet e refuzimit të kërkesës për transferim.*

*Gjatë karrierës time nuk ka ndodhur në as edhe një rast që një çështje të ketë ngelur pezull apo e pa ndjekur nga prokuroria, për arsye të konfliktit të interesit që unë mundet të kem pasur në lidhje me çështjen, pavaësisht emrit, mbiemrit të individit, apo lidhjeve gjini.*

*Theksoj se, në as edhe një rast, pavarësisht pozicionit të individit, nëse ka qenë kallëzuesi apo i kallëzuari, vëlla apo kushdo tjetër gjini e ime, apo bashkëshortit tim, i cili më ka vendosur mua përballe kushteve të konfliktit të interesit, nuk ka ngeluar pa u hetuar apo gjykuar sipas rastit.”*

c) Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2019 është i kërkuar informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë lidhur me disa dosje të procedimeve penale, në të cilat kanë qenë të kallëzuar persona të tjerë të lidhur me të (vëllai, gjini e afërt e subjektit apo bashkëshortit të subjektit).

→ Me shkresën nr. \*\*\* datë 29.3.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë ka dërguar procedimet penale të kërkuara, si më poshtë vijon:

<sup>13</sup> Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2018, drejtuar ONM-së, administruar në dosjen e Komisionit.

1. Procedim penal nr. \*\*\* të vitit 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve” në bashkëpunim, lidhur me një konflikt pronësie, me kallëzues A.M., (vëllai i subjektit të rivlerësimit, sipas deklaramit në përgjigjen e pyetësorit të datës 15 mars), për të cilin është propozuar nga OPGJ-ja pushimi i procedimit penal, me relacionin e datës 27.2.2019.

2. Procedim penal nr. \*\*\* të vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, “Shpërdorim detyre”, me kallëzues G.L., ndaj Përmbarueses Gjqësore Private E.M. Për këtë kallëzim janë kryer veprimet procedurale dhe në përfundim është marrë vendim për mosfillim procedimi (viti 2018). Në vijim, mbi bazën e ankimit të kallëzuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë ka shfuqizuar vendimin e prokurorit dhe e ka kthyer për hetime të mëtejshme, vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër. Në vijim, është regjistruar procedimi penal me nr. \*\*\*/2018 dhe çështja është në hetim.

3. Procedim penal me nr. \*\*\* të vitit 2017 për veprën penale “Vjedhje në bashkëpunim dhe vjedhje duke shpërdoruar detyrën” me kallëzues, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër. Në këtë kallëzim janë kallëzuar punonjësit e postës të cilët kanë kryer veprime tërheqje të pensioneve pas vdekjes së 64 pensionistëve. Procedimi fillimisht është regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Më pas, i është transferuar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Për këtë çështje janë kryer veprimet e para hetimore. Çështja është akoma në hetim për shkak të transferimeve të prokurorëve që kanë hetuar lidhur me këtë procedim.

4. Procedimet penale nr. \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\* e \*\*\* të vitit 2017 për veprat penale të parashikuara nga nenet 135-25 e 134/2 të Kodit Penal “Vjedhje në bashkëpunim dhe vjedhje duke shpërdoruar detyrën” me kallëzues Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore Shkodër ndaj punonjëseve të postës për kryerjen e veprimeve të tërheqjes së pensioneve pas vdekjes të disa pensionistëve. Për këtë çështje janë kryer veprimet e para hetimore. Çështja është akoma në hetim për shkak të transferimeve të prokurorëve që kanë hetuar lidhur me këto procedime.

5. Procedim penal me nr. \*\*\* të vitit 2018, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal “Falsifikim dokumenteve” të pronësisë me kallëzues M.T., ndaj shtetasit P.K. Vihet re se kallëzuesi e ka vënë në dijeni edhe Prokurorinë e Përgjithshme për këtë kallëzim, e cila ka vendosur t’ia dërgojë për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Kallëzimi është regjistruar në datën 5 tetor 2018 nga subjekti i rivlerësimit. Nuk vihet re kryerja e ndonjë veprimi hetimor paraprak nga subjekti i rivlerësimit, për arsye se data 5.11.2018 është zëvendësuar nga një tjetër subjekt i rivlerësimit. Çështja është akoma në hetim për shkak të transferimeve të prokurorëve që kanë hetuar lidhur me këto procedime.

❖ *Në vlerësim të procedimeve të lartpërmendur, nuk duket se ka indice për subjektin që të ketë ushtruar detyrën nën ndonjë konflikt interesi, por se ajo ka marrë masat për të shmangur konfliktin e interesit. Nga hetimi nuk rezultoi që hetimet të jenë zvarritur nën influencën e subjektit të rivlerësimit, pasi zëvendësimet e prokurorëve kanë ndodhur për shkaqe transferimi me urdhër të Prokurorisë së Përgjithshme.*

## **87. Denoncimi i shtetasit M.P.**

Regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2019. Ky denoncim i drejtohet një subjekti tjetër rivlerësimi, për shkelje ligjore të kryera lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2016 për veprën penale “Shpërdorim detyre”, sipas nenit 248 të Kodit Penal. Në këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit referohet në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë.

Faktet e trajtuara në këtë denoncim, vlerësohen se nuk përbëjnë prova për nisjen e hetimit ndaj subjektit të rivlerësimit. Nga shqyrtimi rezultoi se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim *hetimor* apo të kem marrë ndonjë vendim lidhur me këtë çështje.



## **88. Denoncim i një shtetasi anonim.**

Regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 20.3.2019. Ky denoncim trajton pretendime për shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit, për të cilat është ushtruar ankim.

Sipas pikës 2 të germës E të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësive profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.

**89. Trupi gjykues vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjektit i rivlerësimit të cilat ishin në përputhje me dokumentacion e administruar nga organet kompetente dhe në përfundim nuk gjeti indice të cilat të ngrenë dyshime të arsyeshme mbi veprime korruptive të kryera nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpunim me persona të tjerë.**

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elidjana Kasa, me funksion prokurore/drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.
2. Ky vendim i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 30.4.2019

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

### **KRYESUES**

**Olsi Komici**

nënshkrimi

### **ANËTAR**

**Roland Ilia**

nënshkrimi

### **RELATOR**

**Valbona Sanxhaktari**

nënshkrimi

*Sekretare gjyqësore*

**Fiorela Mandro**

nënshkrimi

